# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-464179**
VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Zelensky në Asamblenë e OKB-së: Sa më shumë liri veprimi të ketë Putin, aq më i rrezikshëm bëhet |
| ADRESA | `https://www.cna.al/kosova-bota/zelensky-ne-asamblene-e-okb-se-sa-me-shume-liri-veprimi-te-kete-puti-i475039` |
| BURIMI | cna.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 23 shtator 2026, 20:03:46 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 23 shtator 2026, 19:48:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `755836ea4796bc4c04bb42f968799b354dfb6d7b021ac37b08436e86c7b6022e` |
| TEKSTI | `593be1dfafc264a823fa20d1eeaa0c4f29be0738bb1c3a346d2709e105b7a24a` |
| PAMJA | `b99a479a38deb6b92aa5571e4e6c2466fc9dda760c893ee2a5b67ab07806d45e` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `0015b0f22b68d1b09d7179a336efc53a3a5f75c77791575fba2c21ede2fad0d8` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `55f810520a93a3fb0649992dafdc0630325acd6490d1af12697ee3ba7602edf3` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/0015b0f22b68d1b09d7179a336efc53a3a5f75c77791575fba2c21ede2fad0d8`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

English

# Zelensky në Asamblenë e OKB-së: Sa më shumë liri veprimi të ketë Putin, aq më i rrezikshëm bëhet

23 Shtator 2026, 21:48, Kosova & Bota CNA



Presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky deklaroi nga foltorja e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së se Vladimir Putin është faktori kryesor që pengon përfundimin e luftës në Ukrainë.

Në fjalimin e tij, Zelensky foli fillimisht për humbjet e ushtrisë ruse dhe më pas kritikoi drejtpërdrejt presidentin rus. Sipas tij, Rusia vazhdon luftën pavarësisht humbjeve të mëdha njerëzore dhe territoriale.

> *"Diçka e pengon gjithmonë Putinin të pranojë se 17 milionë kilometra katrorë të territorit të tij, të njohura ndërkombëtarisht nga të gjithë ju, duhet të jenë të mjaftueshme për këtë njeri"*, u shpreh Zelensky.

Ai akuzoi gjithashtu Putinin se kërkon vazhdimisht mbështetje për të zgjeruar luftën dhe për të marrë territore të tjera.

> *"Sa më shumë liri të ketë Putini për të vepruar, aq më i rrezikshëm bëhet bota për të gjithë të tjerët"*, tha presidenti ukrainas, duke shtuar se Rusia duhet të kufizohet në aftësinë e saj për të vazhduar agresionin.

Sipas shifrave të paraqitura nga Zelensky, nga janari deri në gusht ushtria ruse ka humbur 248.964 ushtarë në fushëbetejën në Ukrainë.

> *"Ne kemi video që konfirmojnë secilën prej humbjeve ruse. Këto nuk janë thjesht statistika"*, deklaroi ai.

Zelensky tha se, pavarësisht numrit të madh të viktimave, Rusia gjatë këtij viti ka arritur të pushtojë pak më shumë se 1.000 kilometra katrorë të territorit ukrainas, ndërsa Ukraina,

sipas tij, ka çliruar tashmë një pjesë të konsiderueshme të këtyre territoreve. Gjatë fjalimi të tij, presidenti ukrainas foli edhe për mbështetjen e Koresë së Veriut ndaj Rusisë.

*"Sateliti i Putinit, lideri i Koresë së Veriut, dërgoi trupat e tij në Rusi për të forcuar pikat e dobëta të ushtrisë ruse"*, tha Zelensky.

Sipas tij, edhe forcat koreano-veriore kanë pësuar humbje në luftimet në kuadër të mbështetjes për Rusinë. Zelensky deklaroi se Rusia nuk e kufizon presionin e saj vetëm te Ukraina. Ai përmendi pretendimet ruse ndaj Moldavisë, si dhe kërcënimet ndaj Polonisë dhe vendeve baltike.

*"Rusia ka pretendime ndaj fqinjës sonë Moldavisë. Ajo kërcënon vazhdimisht Poloninë dhe vendet baltike"*, tha ai.

Sipas Zelenskyt, Moska gjithashtu nuk respekton sovranitetin e vendeve të Kaukazit Jugor dhe Azisë Qendrore. Ai përmendi edhe Sirinë dhe Afrikën, duke i lidhur veprimet ruse në këto rajone me pasoja të rënda për popullsinë civile. Zelensky e përfundoi këtë pjesë të fjalimit duke argumentuar se lufta në Ukrainë nuk është vetëm një konflikt mes dy vendeve, por një çështje që, sipas tij, prek sigurinë ndërkombëtare. /CNA








## Të sugjeruara

### "Nuk takohemi me Haxhiun, pa vendosur Kuvendi për 'Specialen'"/ Letra e familjeve Thaçi, Veseli dhe Krasniqi

**"Do të ketë surpriza"/ Paralajmërimi i Netanyahut para fjalimit në Asamblenë e OKB-së**

**Mbyllet Koloseu në Romë/ Shkak bëhet vdekja e një punëtori**

**Presidenti i Iranit merr fjalën në OKB/ Delegati amerikan braktis sallën**

**Helikopteri ushtarak rus hyn në hapësirën ajrore të Polonisë/ Ngrihen në ajër avionët luftarakë polakë**

**Analiza/ Ja cilët udhëheqës mungojnë në Asamblenë e OKB-së dhe pse**

**Pasojat e rezultateve nga zgjedhjet/ Merz anulon vizitën në OKB, mbledh CDU-në**

**"Kuvendi të zgjedhë nënkryetarin e dytë"/ GJK: Qeveria e Kosovës është zgjedhur në mënyrë kushtetuese**

**Edhe pse shumë herët, gara presidenciale e vitit 2028 në SHBA ka nisur/ Emrat e mundshëm të kandidatëve**

**AfD në Saksoni-Anhalt/ Çfarë është "detyrimi i federatës"?**

**Kallas takon Kurtin dhe Vuçiç-in: Marrëveshja e Ohrit është e detyrueshme**

**Fjalimi në OKB/ Trump zbulon afatin, ja kur pritet të arrijë marrëveshje paqeje me Iranin**

**Spanja mund ta pengojë integrimin e Malit të Zi në BE**

**Trump në OKB: Po shoh mundësinë e "asgjësimit" të Iranit, t'i dërgoj në ferr**

**"Super Inteligjenca"/ Trump "riemërton" IA-në, hedh poshtë thirrjet për rregullore globale**

**Bojkoti i madh në SHBA/ Televizionet kryesore ndërpresin mbulimin e Trump**

**Të shtëna me armë në një shkollë në Turqi/ Plagosen 11 nxënës**

**Kryeministri britanik Andy Burnham do të takohet me Trump-in për herë të parë në OKB në Nju Jork**

**Kurti takon Erdogan-in: Diskutuam aktgjykimin e padrejtë të Speciales, të korrigjohet në Apel**

**[Hetimet ndaj Granit Xhakës/ Ja sa vite burg rrezikon futbollisti]**

## editorial

16:30 Editorial

**Agasi, Veliaj, Proda, Hyseni; Harta e një shteti që po shpërbëhet**

**CNA LIVESTREAM**



Na ndiqni edhe në

## acromax

19:53 Acromax / Aldor Nini

**Skandali- dokumenti/ Acromax i Aldor Ninit raportoi CNA duke abuzuar me RTSH**

## opinion

20:06 Opinione Grigels Muçollari

**Po tani, kush do ta shpëtojë Shqipërinë nga turpërimi?!**

19:14 Opinione Luan Rama

**TRADHËTIA NDAJ SHTETIT**

22:05 Opinione Luan Rama

**Kur kryeministri është edhe president dhe presidenti ndihmës i kryeministrit**

## Lifestyle

14:00 Lifestyle

**Ishte shtruar në klinikë rehabilitimi/ Ndërron jetë djali i modeles së njohur**

Presley Gerber, djali i supermodeles Cindy Crawford, ka nd...

09:00 Lifestyle

**Jeshilja e ullirit/ Si ta kombinoni ngjyrën elegante që po "pushton" vitin**

Jeshilja e ullirit po rikthehet fuqishëm dhe premton të bë...

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.